



Në kuadër të projektit “Partneriteti lokal kundër abuzimit të drogave dhe delikuencës së të miturve”

Marrëveshje shumëpalëshe bashkëpunimi

Ulqin - Në zyrën e kryetarit të Komunës së Ulqinit, të enjten u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes Komunës së Ulqinit, Prokurorisë Themelore Shtetërore në Ulqin, Gjykatës Themelore në Ulqin, Njesisë së Policisë në Ulqin, Qendrës për Punës Sociale – Njësia rajonale Ulqin, Shtëpisë së Shëndetit – Ulqin dhe Organizatës së Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri”.

Në marrëveshje thuhet se palët nënshkruese do të sigurojnë realizimin e bashkëpunimit në çështjet e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, shkëmbimit të njohurive dhe përvojave, parandalimit të narkomanisë, sjelljeve të papranueshme dhe dukurive të tjera negative në komunitetin lokal.

Ata po ashtu kanë marrë përsipër të delegojnë përfaqësuesit e vet profesionistë për pjesëmarrje në trajnimin e edukatorëve për luftimin e drogave dhe sëmundjeve të varësisë, hartimin e udhëzuesit special “Fëmijët në konflikt me ligjin”, paraqitje mediatike dhe ngjarje publike, hartimin e Planit Lokal të Veprimit për parandalimin e narkomanisë dhe kriminalitetit të të miturve etj.

Marrëveshja shumëpalëshe e bashkëpunimit u nënshkrua nisur nga besimi se bashkëpunimi i pushtetit vendor, institucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile sjell bashkimin e potencialeve të tyre dhe rezulton me projekte të dobishme për qytetarët e komunës së Ulqinit, si dhe nisur nga

përvojat pozitive të bashkëpunimit të deritanishëm.

Marrëveshja ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së të rinjve për dëmet e abuzimit me droga, zvogëlimin e shkallës së sjelljeve delikuede dhe të papranueshme në mesin e të rinjve në komunitetin lokal, si dhe të forcimit të kapaciteteve të Zyrës lokale për parandalimin e narkomanisë.

Nënshkrimi i marrëveshjes u realizua në kuadër të projektit “Partneriteti lokal kundër abuzimit të drogave dhe delikuencës së të miturve”, të cilin e mbështet Ambasada e SHBA-së në Podgoricë, përmes Zyrës për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

(Kohapress)